



Pranuar / Doretuar Punimjenof/Prodato Received/Delivety	28 - 07 2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMESHUK	4391/2022		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.569/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.569/2022 të datës 27.06.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi kundër Vendimit me numër KD.Nr.021/2022 të datës 20.05.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.569/2022 e datës 27.06.2022 e parashtruar nga ankuesja.
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër KD.Nr.021/2022 i datës 20.05.2022 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, më datë 27.06.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3723/2022, kundër Vendimit me numër KD.Nr.021/2022 të datës 20.05.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.07.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Shërbimi Korrektues të Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë

05.07.2022 ka pranuar nga Shërbimi Korrektues të Kosovës përgjigjen në kërkesë së bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 3723/2022 të datës 27.06.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër KD.Nr.021/2022 të datës 20.05.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Ftesën për intervistë e datës 05.05.2022; Inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankueses e datës 29.03.2022; Raportin Përfundimtar të Hetimeve për incidentin e datës 19.03.2022 i datës 25.03.2022 nga Komisioni Hetimor i Shërbimit Korrektues të Kosovës; Zarin e datës 24.05.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 01.07.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 05.07.2022; Kontratë punë për kohë të pacaktuar të datës 30.06.2018; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor i datës 05.05.2022; Përshkrimin e detyrave të punës Zyrtar Korrektues datë 03.01.2020; Vendim me Nr. 610 i datës 22.03.2022 për Komisionin Hetimor; Vendimin me Nr.021 i datës 06.05.2022 për vazhdimin e afatit për vendosje.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesja është e **pabazuar, SEPSE:**

Nga administrimi i provave materiale Kolegji i Këshillit ka gjetur që ankuesja në bazë Kontratës së Punë për Kohë të Pacaktuar (pa datë të nënshkrimit) është e punësuar në pozitën *Zyrtare Korrektues* në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë.

Drejtori i Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë, përmes Vendimit më numer protokolli 610 të datës 22. 03.2022, ka themeluar Komisionin Hetimor për hetim të rastit të datës 19.03.2022 lidhur me mosmarrëveshjen e ankueses me mbikëqyrësin dhe kuzhinieren gjatë shpërndarjes së darkës.

Komisioni Hetimor në bazë të Raportit Përfundimtar të Hetimeve me numër protokolli 672 të datës 28.03.2022 ka konstatuar së ankuesja me veprimet e saj ka bërë shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 2 pika 3.6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, duke rekomanduar që ndaj ankueses të iniciohet procedurë disiplinore.

Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës më datë 20.05.2022 ka nxjerr Vendimin KD.Nr.021/2022, me të cilin ka shpallur përgjegjëse ankuesen për shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3 pika 3.3, 3.6 dhe 3.8 lidhur me nenin 25 dhe nenin 28 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe ka shqiptuar masën disiplinore *“Ndalim 20% i pagës për periudhë një muaj”*.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër KD.Nr.021/2022 të datës 20.05.2022 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, pretendon që ky komision nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe juridike, duke theksuar se vendimi i kundërshtuar bazohet vetëm në deklarata dhe jo në fakte. Propozon që të aprovohet ankesa si dhe të anulohet Vendimi i Komisionit Disiplinor

lidhur me shqiptimin e masës disiplinore dhe të detyroj të njëjtin që ta largoj masën disiplinore nga dosja personale e ankueses.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i'u referua dispozitave të nenit 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit".* Ndërlidhur me këtë, sipas nenit 46 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, shkeljet e rënda të detyrave të punë janë kualifikuar: 3.1. mospërmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrë; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i delur në punë".

Bazuar në provat e lëndës gjegjësisht Raportit Përfundimtar të Hetimeve me Nr.672 të datës 28.03.2022 të Komisionit Hetimor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ankuesja me datw 19.03.2022 në kohë të darkës ka pasur një fërkim verbal me shërbyesen e ushqimit gjegjësisht kuzhinieren znj.

lidhur me shpërndarjen e ushqimit brenda Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë, ku ankuesja është shërbyer me ushqim para se të shërbehen pacientët. Po ashtu në bazë të këtij raporti dhe deklaratave të zyrtareve prezent në ditën e ngjarjes rezulton se ankuesja ka angazhuar z.

që një qese (thes) me bukë të qes jashtë objektit, dhe së e njëjta me çarçaf të institucionit ka mbuluar veturën private.

Po ashtu nga deklaratat e dhe Kryeinfermieri' të dhëna pranë Komisionit Hetimor, rezulton se ankuesja në vazhdimësi ka pas mosmarrëveshje me stafin e IPKF-së. Ndërsa pastruesi ne deklaratën e tij të dhënë në Komisionin hetimor ka konfirmuar së ankuesja me datë 19.03.2022 ka kërkuar nga ai që ta qes jashtë të sigurimi një thes të zi, në të cilin ka pas bukë po që të njëjtin nuk e ka hap.

Andaj, duke marrë parasysh rrethanat si me lartë, Kolegji i Këshillit vlerëson së ankuesja me veprimet e saj ka vepruar në kundërshtim me nenin 25 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: *"2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike",* sepse, zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i



përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij, siç parashihet me nenin 28 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, rrjedhimisht mbi këto arsye Kolegji konstaton se Komisioni Disiplinor ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat materiale me rastin e vërtetimit të përgjegjësisë disiplinore të ankueses, duke vepruar në pajtim me nenin 48 paragrafi 3 dhe nenin 50 paragrafi 1 të këtij Ligji me të cilin është përcaktuar se: 48.3 Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor..... 50.1 Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmi” 2. Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer. e mbi këtë konstatim Kolegji vlerëson se janë të pa bazuar pretendimet ankimore të ankuesit, e në këtë kuptim pretendimet ankimore të ankuesit se vendimi i Komisionit Disiplinor është nxjerrë me konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike është i padrejtë dhe antiligjor, janë të pabazuara.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS Lënda me numër A.nr.569/2022

Avdyl BEKTESHI

Behteshi
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Ardita Haxhnikaj-DEMI
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

